




**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/ 693
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Carralevë

E enjte, më 19 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 19:45 – 21:20

Vendi i takimit: SHF "Avdullah Shabani"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës, z.Qemajl aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti si dhe Asambleistët- Sanie Sadiku dhe Besnik Seferi.

Dëgjimet buxhetore të cilat ishin të parapara për Organizatat, Partit Politike, qytetarët e Shtimes nuk u mbajtën për shkak të mos prezencës së grupeve dhe qytetarëve.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryetari i Komunës z. Qemajl Aliu: Faleminderit së pari që sot keni gjetë kohë që të jeni pjesë e këtij dëgjimi publik. Unë sot jam këtë së bashku me Kryesuesin e Kuvendit, Adnan Ademi, Drejtorin e infrastrukturës, Grejtalb Emini, Drejtorin e Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushiti si dhe Asambleistët Besnik Seferi, Sanie Sadiku.

Jemi sonte këtu në kuadër të dëgjimeve publike, ku është viti i katërt me radhë dhe besoj që ne tashme veçse jemi familjarizuar. Janë dy mënyra që të buxhetohen projektet, njëra rrugë është kërkesat e komunitetit direkt, që janë domethënë kërkesat e juaja, e ana tjetër janë premtimet të cilat ne i kemi dhënë si qeverisje në krye të rradhës kur kemi ardhur të ua kërkojmë besimin. Këto dy komponenta janë ato të cilat e bëjnë cdo vit që ne të jemi këtu dhe t'i marrim kërkesat e juaja t'i buxhetojmë dhe më pas ato projekte të realizohen.

Komuna e Shtimes këtë vit e ka buxhetin rreth 11.5 milion, ne e kemi gjetë 7.8 milion euro, tash ka arrit deri 11.5 milionshi kjo falë financimit më të mirë që po e bënë qeveria, po ndan grant për komunat më shumë, por edhe në performancë të mirë në mbledhjen e taksave në nivel qendror. Megjithatë edhe pse janë 11.5 milion euro për komunën janë pak, diku përmbi 50% e këtij buxheti shkon për paga dhe mëditje, pjesa tjetër pastaj mbetet për investime kapitale, mallr dhe shërbime, subvencione si dhe komunali.

2.5 milion euro janë investime kapitale për të cilat më shumë flitet në këto takime.

Ne mundohemi të ndajmë buxhetin e barabartë për secilin fshat, por përvec buxhetit komunal e kemi edhe buxhetin qeveritarë. Kësaj rrugë ne si Shtime na ka buzëqeshur fati, sepse të gjitha projektet që i kemi dorëzuar ne si qeverisje, të gjitha na i kanë pranuar, sepse atje e kemi pasur një qeverisje dashamirëse dhe një Kryeministër dashamirës.

Një llogaritje të cilën ja kemi bërë të gjitha investimeve të cilat janë bërë në komunën e Shtimes, projektet e mëdha të cilat janë duke e transformuar komunën tonë, janë diku rreth 55 milion euro që po investohen nga qeveria Kurti. Kto projekte janë të përqëndruara më shumë në qytet por po prekin edhe secilin vendbanim.

Tani mund ta merrni fjalën dhe të bëni kërkesat e juaja pa hezituar fare, faleminderit edhe një herë që jeni sot këtu me ne, në këtë dëgjim publik.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Zenel Balaj:** Kemi probleme me ujësjellësin.
Në pjesën e shkollës ka shumë mbeturina dhe është problem, nëse ka mundësi të hiqen, po ashtu edhe bari të kositet.
- **Lulzim Balaj:** Tek Xhamia pjesa e lumit është shumë e dëmtuar
- **Xheladin Xheladini:** Tek fusha lart të asfaltohet një rrugë (50m)
Fusha e sportit të ndricohet
- **Fazli Fazliu :** Kanalizimi a do të rregullohet?
Të bëhet zgjerimi i rrugës Caralevë-Zborc (200m), për zgjerim të kanalit atmosferik.
- **Ahmet Murtezi:** Procka e hapur duhet të zgjerohet për shkak të problemit me ujërat e zeza (Rruga Caralevë-Zborc)
- **Liman Hasani:** Dy rrugë kemi nevojë të asfaltohen tek rruga Caralevë-Zborc
- **Nexhmedin Çerkini:** Rruga tek varrezat sa metra është në projekt që të asfaltohet?
- **Osman Balaj:** Në lagje Balaj kanalizimi të vazhdohet 400m.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO





KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Carraleve

Date: 19.06.2025

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	LIJMAN HASANI	Hasani
2	Ahmet Murtezi	Murtezi
3	ARBEN FAZUJA	Fazua
4	Freskim Agri	Agri
5	JETON HASRIZI	Hasrizi
6	Osman Jetullahi	Jetullahi
7	INRI HYSEMI	Hysemi
8	Emrit Hysemi	Hysemi
9	Gjon Hoxhizi	Hoxhizi
10	FATMIR MURTEZI	Murtezi
11	Feriz Fazliu	Fazliu
12	LULZIH BALAJ	Balaj
13	HEROJD BEHA	Beha
14	NEXHMEJDI DERRKINI	Derrkini
15	BASHKIM FAZLIU	Fazliu
16	ARSIN BALAJ	Balaj
17	Fatmir Balaj	Balaj

18	Anber Delu	
19	Feiz Baldj	
20	Festim Baldj	
21	Edon Hosani	
22	Frestim Ajrizi	
23	Sylef Ajrizi	
24		
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		
38		
39		
40		
41		